



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.561/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada Glloxhani, dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Syla, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për kryetar të Kuvendit Komunal të Junikut Syl Gaxherri, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Junik, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 02.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pasafatshme ankesa e kandidatit për kryetar të Kuvendit Komunal të Junikut Syl Gaxherri, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Junik, me shenjen ZL.Anr.561/2017 e datës 01.11.2017, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP, më datë 01.11.2017, ka pranuar një ankesë nga kandidati për kryetar të Kuvendit Komunal Syl Gaxherri, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Junik, me të cilën ka pretenduar se me datë 22.10.2017, në Vendvotimin 3101C/01R, në Junik në ora 15:40 minuta, është nxjerrë jashtë vendvotimit 3101C/01R një fletëvotim nga një qytetar Sali Gacaferi, që shihet në video. Pasi që ka përfunduar votimi dhe numërimi i votave është konstatuar nga komisionerët kompetent nga të gjitha subjektet politike prezent, që mungon një fletëvotim. Pastaj, menjëherë janë marrë masat e duhura dhe janë lajmëruar organet e policisë dhe prokurori i shtetit, për fat të keq prokurori nuk ka qenë në vendvotim që nga ora 17:00 dhe pasi që e kanë kontaktuar kryeprokurorin e shtetit (me anë të telefonit), prokurori i shtetit ka ardhur në Vendvotim në ora 22:30 minuta.

Më tej ka theksuar se Prokurori është konsultuar me komisionerët dhe policinë, pastaj rreth orës 23:00, kanë shkuar në shtëpinë e Sali Gacaferit dhe se i njëjti është marrë në pyetje nga policia dhe prokurori me dyshimin se ka marrë fletëvotimin me vete, mirëpo aty nuk kanë gjetur asgjë. Pas kësaj, komisioneri Sahit Tofaj, ka kërkuar nga prokurori që të shkon tek qytetari Sali Gacaferi dhe ta kontrollojë pa prezencën e askujt ku më pas i njëjti e ka sjellë fletëvotimin me arsyetimin se është gjetur në xhepin e Sali Gacaferit. Me këtë rast ka theksuar se është manipuluar me votën e qytetarit dhe se komisionerët kanë vepruar jashtë çdo rregulle ligjore.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një CD lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit, sipas nenit 119 të LZP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 5.3 i Rregullës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa, e njëjta është dorëzuar në PZAP më datë 01.11.2017, nga parashtruesi i ankesës. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në ankesën ZL.Anr.561/2017 të datës 01.11.2017, ndërlidhet me parregullsitë gjatë procesit të votimit, për ditën e votimit të datës 22.10.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 23.10.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka parashtruar në PZAP me datën 01.11.2017, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.3, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 5 par. 5.3, neni 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.561/2017 më datën 02.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.